

**RREGULLORE
E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT
“PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE
PËR HEQJE DORË TË GJYQTARIT
NGA SHQYRTIMI I NJË ÇËSHTJEJE NË JURIDIKSIONIN DISIPLINOR”**

Miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 24, datë 11.06.2018

Në mbështetje të neneve 179, pika 7 dhe 179/b, pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 5, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 13 shkronja “d”, 32, pika 1 dhe 36 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Mbledhja e Gjyqtarëve

VENDOSI:

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton procedurën e shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (Kolegji) për heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete në Juridiksionin Disiplinor sipas nenit 5, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Neni 2
Parimet**

Kjo rregullore bazohet në parimet e ligjshmërisë, paanësisë, efikasitetit dhe objektivitetit.

**Neni 3
Kërkesa për heqje dorë**

1. Gjyqtari i Kolegjit, i cili vlerëson se ndodhet në një nga rastet e parashikuara nga neni 36 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kërkon heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete në Juridiksionin Disiplinor, brenda një afati të arsyeshëm.
2. Kërkesa, pasi protokollohet, paraqitet te Kryetari i Kolegjit. Në rastin kur kërkues është Kryetari i Kolegjit, kërkesa i paraqitet gjyqtarit më të vjetër në moshë, i cili merr kompetencat e Kyetarit gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë.

3. Në kërkesën e tij, gjyqtari parashtron shkaqet duke treguar faktet dhe rrethanat në të cilat bazohet në kërkesën për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje konkrete. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumente/akte provuese, nëse ka të tilla.

Neni 4

Shqyrtimi i kërkesës për heqje dorë

1. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për heqje dorë, thërret Mbledhjen e Gjyqtarëve për shqyrtimin e saj, në momentin më të parë të mundur, duke u kujdesur që kuorumi i nevojshëm për shqyrtimin e saj të jetë jo më pak se dy të tretat (5 gjyqtarë) e gjithë gjyqtarëve të Kolegjit.
2. Kërkesa për heqje dorë shqyrtohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve pa pjesëmarrjen e gjyqtarit që ka bërë kërkesën.
 3. Për kërkesën për heqje dorë të gjyqtarit, vendos shumica e gjyqtarëve që shqyrtojnë kërkesën. Në çdo rast, abstenimi nuk lejohet. Kryetari i Kolegjit, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, organizon një votim të njëkohshëm të të gjithë anëtarëve, duke mbledhur votat pro dhe kundër.
4. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve jepet i arsyetuar dhe zbardhet nga Kryetari i Kolegjit ose nga gjyqtari më i vjetër në moshë, kur mbledhja kryesohet prej tij, brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Ky vendim bëhet pjesë e fashikullit gjyqësor të çështjes, për të cilën është kërkuar heqja dorë. Në rast se Kryetari i Kolegjit është në pakicë, vendimi zbardhet nga gjyqtari më i vjetër në moshë nga gjyqtarët që janë në shumicë.
5. Në rast se kërkuesi është anëtar i Kolegjit për shqyrtimin paraprak të ankimit ose relator i çështjes dhe kërkesa e tij për heqje dorë miratohet, Kryetari menjëherë merr masa për hedhjen e shortit për zëvendësimin e tij.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe ndryshimi i rregullores

1. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit.